



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION**

Mbështetur në nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 dhe nenin 41 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, në lidhje me nenin 95 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 prill 2025, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PROVIMIN NGA KODI I ETIKËS PROFESIONALE PËR AVOKATË

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe mënyrën e organizimit, administrimit, zhvillimit dhe vlerësimit të Provimit nga Kodi i Etikës Profesionale për Avokatë.
2. Me këtë Rregullore rregullohen, në veçanti, paraqitja e Provimit, objekti dhe burimet e testimit, përgatitja e pyetjeve, mënyra e zhvillimit dhe vlerësimit, shpallja e rezultateve, e drejta e ankesës, përsëritja e Provimit, evidentimi i rezultateve dhe lëshimi i certifikatës.
3. Qëllimi i Provimit është verifikimi i njohurive të kandidatit mbi standardet etike, profesionale dhe juridike që lidhen me ushtrimin e ligjshëm, të pavarur dhe profesional të avokatisë.

Neni 2

Parimet

1. Provimi organizohet dhe administrohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë së kandidatëve, objektivitetit, paanshmërisë dhe integritetit të procesit.
2. Kandidatët që i nënshtrohen të njëjtit afat të Provimit trajtohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta të vlerësimit.

3. Kjo Rregullore zbatohet dhe interpretohet në harmoni me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK-së dhe Kodin e Etikës Profesionale për Avokatë.

Neni 3

Organizimi dhe administrimi i Provimit

1. Provimi organizohet dhe administrohet nga Oda e Avokatëve të Kosovës.
2. OAK kujdeset për përgatitjen e pyetjeve, organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit, kontrollin dhe vlerësimin e testeve, shpalljen e rezultateve, shqyrtimin e ankesave, mbajtjen e evidencave dhe lëshimin e certifikatave.
3. OAK ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje, në përputhje me organizimin e saj të brendshëm.

KAPITULLI II

PARAQITJA DHE ORGANIZIMI I PROVIMIT

Neni 4

E drejta për t'iu nënshtruar Provimit

1. Të drejtë për t'iu nënshtruar Provimit kanë kandidatët që kanë përfunduar Fakultetin Juridik dhe kanë dhënë provimin e jurisprudencës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Plotësimi i kushteve për hyrje në Provim verifikohet nga OAK.

Neni 5

Paraqitja e Provimit

1. Kandidati paraqet kërkesën për t'iu nënshtruar Provimit brenda afatit të përcaktuar nga OAK.
2. Me kërkesën dorëzohen dokumentet e nevojshme për vërtetimin e plotësimit të kushteve për hyrje në Provim, përveç dokumenteve që tashmë gjenden në evidencat e OAK-së.
3. Paraqitja e Provimit mund të bëhet në formë fizike, elektronike ose në një mënyrë tjetër të përcaktuar nga OAK.

Neni 6

Njoftimi për mbajtjen e Provimit

1. OAK publikon ose ua komunikon kandidatëve njoftimin për mbajtjen e Provimit.
2. Njoftimi përmban të dhënat e nevojshme për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së Provimit, afatin për paraqitje, si dhe udhëzimet e tjera të nevojshme për kandidatët.
3. Varësisht nga numri i kandidatëve dhe nevojat organizative, Provimi mund të zhvillohet në një ose më shumë grupe.

KAPITULLI III

OBJEKTI DHE BURIMET E PROVIMIT

Neni 7

Objekti i Provimit

1. Provimi ka për objekt vlerësimin e njohurive të kandidatit mbi parimet, rregullat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që lidhen me ushtrimin e ligjshëm, të pavarur, profesional dhe etik të profesionit të avokatit.
2. Përmbajtja e Provimit mund të përfshijë edhe çështje dhe situata praktike në të cilat kërkohet njohja ose zbatimi i standardeve që burojnë nga ushtrimi i profesionit të avokatit.
3. Provimi nuk ka për qëllim testimin e përgjithshëm të njohurive juridike të kandidatit për çështje që nuk kanë lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit.

Neni 8

Burimet e Provimit

1. Burim themelor i Provimit është Kodi i Etikës Profesionale për Avokatë.
2. Për atë që lidhen me ushtrimin e profesionit të avokatit, pozitën e tij profesionale, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që burojnë prej tij, pyetjet e Provimit mbështeten edhe në:
 - 2.1. Ligjin për Avokatinë;
 - 2.2. Statutin dhe aktet e tjera normative të OAK-së;
 - 2.3. Kodin e Procedurës Penale, në pjesët që lidhen me pozitën, të drejtat, detyrimet dhe ushtrimin e funksionit të mbrojtësit;
 - 2.4. legjislacionin që rregullon procedurën kontestimore dhe procedurat e tjera gjyqësore, në pjesët që lidhen me përfaqësimin, autorizimin dhe pozitën procedurale e profesionale të avokatit;
 - 2.5. legjislacionin tjetër që rregullon ose prek ushtrimin e profesionit të avokatit, përfshirë çështjet që lidhen me sekretin profesional, konfidencialitetin, konfliktin e interesit, përfaqësimin, mbrojtjen dhe ndihmën juridike;
 - 2.6. instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare relevante për pavarësinë, mbrojtjen dhe ushtrimin e profesionit të avokatit, përfshirë instrumentet e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e profesionit të avokatit;
 - 2.7. aktet, standardet dhe çështjet e tjera juridike ose profesionale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e profesionit të avokatit.
3. Burimet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni përdoren në masën në të cilën çështja e testuar lidhet me pozitën, të drejtat, detyrimet ose përgjegjësitë profesionale të avokatit.

4. Përmbajtja e Provimit nuk mund të interpretohet ose zbatohet në mënyrë që të krijojë kushte materiale për ushtrimin e profesionit përtej atyre të përcaktuara me ligj.

Neni 9

Përgatitja e pyetjeve

1. Pyetjet e Provimit përgatiten nga OAK para mbajtjes së Provimit.
2. Pyetjet duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mbështetura në burimet e përcaktuara me këtë Rregullore.
3. Për secilën pyetje përcaktohet paraprakisht përgjigjja e saktë ose, sipas natyrës së pyetjes, përgjigjet e sakta.
4. Pyetjet dhe përmbajtja e testit ruhen në konfidencialitet deri në fillimin e Provimit.

KAPITULLI IV

ZHVILLIMI DHE VLERËSIMI I PROVIMIT

Neni 10

Mënyra e zhvillimit të Provimit

1. Provimi zhvillohet me shkrim.
2. Provimi mund të përmbajë pyetje me alternativa, pyetje me një ose më shumë përgjigje të sakta, situata praktike, si dhe forma të tjera të përshtatshme të testimit.
3. Kohëzgjatja e Provimit përcaktohet nga OAK duke marrë parasysh numrin, natyrën dhe kompleksitetin e pyetjeve dhe u bëhet e ditur kandidatëve para fillimit të tij.

Neni 11

Rregullat gjatë Provimit

1. Kandidati është i detyruar t'u përmbahet rregullave dhe udhëzimeve për zhvillimin e Provimit.
2. Gjatë Provimit ndalohet përdorimi i materialeve ose pajisjeve të paautorizuara, komunikimi me kandidatët e tjerë, dhënia ose marrja e ndihmës, si dhe çdo veprim tjetër që cenon rregullsinë ose integritetin e procesit.
3. Në rast të shkeljes së rëndë të rregullave të Provimit, OAK mund ta ndërpresë Provimin për kandidatin përkatës dhe ta shpallë testin e tij të pavlefshëm.

Neni 12

Vlerësimi

1. Vlerësimi i Provimit bëhet mbi bazën e përgjigjeve të përcaktuara paraprakisht dhe sipas kritereve të njëjta për të gjithë kandidatët.
2. Kandidati konsiderohet se e ka kaluar Provimin nëse arrin së paku shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të pikëve të përgjithshme.
3. Kur gjatë kontrollit konstatohet se një pyetje është e paqartë, e pasaktë ose, për shkak të formulimit apo përmbajtjes së saj, nuk mund të vlerësohet në mënyrë të njëtrajtshme, OAK përcakton mënyrën e trajtimit të saj.
4. Mënyra e trajtimit të pyetjes sipas paragrafit 3 zbatohet njësoj ndaj të gjithë kandidatëve të të njëjtit afat.

Neni 13

Kontrolli i testeve

1. Testet kontrollohen nga OAK para shpalljes së rezultateve.
2. Kontrolli përfshin vlerësimin e përgjigjeve dhe përllogaritjen e rezultatit të arritur nga kandidati.
3. Gabimet eventuale të konstatuara gjatë kontrollit korrigjohen para shpalljes së rezultateve.

KAPITULLI V

REZULTATET DHE ANKESA

Neni 14

Shpallja e rezultateve

1. Rezultatet e Provimit u komunikohen kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm, pas përfundimit të kontrollit dhe vlerësimit të testeve.
2. Rezultati i komunikohet kandidatit përmes postës elektronike ose në një mënyrë tjetër zyrtare të komunikimit.
3. Në rast të publikimit të rezultateve, OAK vepron në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 15

E drejta për shikimin e testit

1. Kandidati ka të drejtë të kërkojë shikimin e testit të vet pas pranimit të rezultatit.

2. Shikimi i testit bëhet në mënyrën e përcaktuar nga OAK, duke ruajtur konfidencialitetin e pyetjeve dhe mbrojtjen e të dhënave të kandidatëve të tjerë.
3. Për mbrojtjen e integritetit të Provimit, OAK mund të kufizojë kopjimin, fotografimin ose shpërndarjen e testit.

Neni 16

E drejta e ankesës

1. Kandidati i pakënaqur me rezultatin e Provimit ka të drejtë të paraqesë ankesë në OAK.
2. Ankesa duhet të përmbajë pretendimet mbi të cilat kandidati mbështet kundërshtimin e rezultatit.
3. Afati dhe mënyra e paraqitjes së ankesës përcaktohen me njoftimin për rezultatet dhe zbatohen njësoj ndaj të gjithë kandidatëve të të njëjtit afat.

Neni 17

Shqyrtimi i ankesës

1. OAK shqyrton ankesën duke marrë për bazë testin e kandidatit, përgjigjet e dhëna, kriteret e vlerësimit dhe pretendimet e ngritura në ankesë.
2. Kur gjatë shqyrtimit të ankesës konstatohet gabim që ka ndikuar në rezultatin e kandidatit, OAK bën korrigjimin përkatës.
3. Kur, për nga natyra e tij, gabimi i konstatuar mund të ketë ndikuar edhe te kandidatët e tjerë, OAK ndërmerr verifikimin e nevojshëm edhe në raport me ta.
4. Kandidati njoftohet për rezultatin e shqyrtimit të ankesës.

KAPITULLI VI

PËRSËRITJA E PROVIMIT, CERTIFIKIMI DHE EVIDENTIMI

Neni 18

Përsëritja e Provimit

Kandidati që nuk e kalon Provimin ka të drejtë t'i nënshtrohet përsëri në një afat tjetër të organizuar nga OAK.

Neni 19

Certifikata

1. Kandidati që e kalon me sukses Provimin pajiset me certifikatë nga OAK.
2. Certifikata përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e kandidatit, datën e dhënies së Provimit dhe numrin përkatës të evidencës.

Neni 20

Evidentimi dhe ruajtja e dokumentacionit

1. OAK mban evidencë për kandidatët që i janë nënshtruar Provimit dhe për rezultatet e arritura.
2. Evidencat dhe dokumentacioni që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e Provimit ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e OAK-së.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Çështjet e parregulluara

Për çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Rregullore, veprohet në përputhje me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK-së, Kodin e Etikës Profesionale për Avokatë dhe aktet e tjera të zbatueshme.

Neni 22

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Provimin nga Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve, e miratuar më 28 dhjetor 2013, si dhe çdo dispozitë tjetër e akteve të OAK-së që është në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës.

Prishtinë, më 15 prill 2025

Besnik R. BERISHA
Kryetar i OAK

